



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ Prot.,

Tiranë më _____.____.2025

V E N D I M

Nr.11 datë 27. 08.2025

PËR

**MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT: “ANALIZË E TREGUT
TË TELEFONISË FIKSE - TREGJET ME SHUMICË TË TERMINIMIT DHE
TRANZITIMIT TË THIRRJEVE NË RRJETET TELEFONIKE PUBLIKE NGA
VENDNDODHJE FIKSE”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Gentian	Sala	Kryetar
2. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtare
3. Z. Lorenc	Bako	Anëtar
4. Z. Bleron	Dokle	Anëtar
5. Z. Armer	Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Kledja Cikopano në mbledhjen e datës 27.08.2025, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it, miratuar me vendimin nr.7, datë 16.2.2017 si dhe ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

- “Miratimin për këshillim publik të dokumentit “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse*”.

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 87 e në vijim i Kreut XIII-të “Analiza e Tregut dhe Fuqia e Ndjeshme në Treg”, Kreu XIV-të, “Detyrimet për akses ndaj sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg”, të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
2. Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 44/2015);

3. Rregullore nr. 9, datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut”, e ndryshuar;
4. Rregullore për Procedurat e Këshillimit Publik, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 21, datë 7.12.2021.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti: “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse”;
2. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i Projektvendimit;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Dokumenti “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse” është hartuar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores nr. 9, datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut” dhe merr në konsideratë Rekomandimet dhe Direktivat e BE-së për rregullimin e tregjeve të komunikimeve elektronike.
2. Ky dokument:
 - a. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë së të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
 - b. nga pikëpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin Ligjit nr. 54/2024 dhe Rregulloren për Analizën e Tregut 9/2009;
 - c. nga pikëpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizën e tregut në nenet 87 e në vijim i Kreut XIII-të, “Analiza e Tregut dhe Fuqia e Ndjeshme në Treg”, Kreu XIV-të, “Detyrimet për akses ndaj sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg”, të Ligjit nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” si dhe listën e tregjeve të përcaktuara në Rregulloren nr. 9, datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut”, e ndryshuar, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;
 - d. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Evropian dhe praktikën më të mirë rregullatore në vendet e Bashkimit Evropian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut në Shqipëri;
 - e. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 92, Kreu XIV “Detyrimet për akses ndaj sipërmarrësve me Fuqi të

Ndjeshme në Treg”, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr.54/2024.

3. Dokumenti “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse – Dokument për Këshillim Publik*” përmban:
- përkufizimin e tregjeve përkatëse të analizuar: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse;
 - analizë e konkurrencës në tregjet përkatës dhe vlerësimin nëse ka operatorë me fuqi të ndjeshme në treg;
 - masat rregulluese të propozuara për sipërmarrësit e vlerësuar me FNT, përfshirë rregullimin e tarifave për FTR;
 - Propozim për de-rregullim të tregut me shumicë të tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse.
4. Pas përfundimit të Këshillimit Publik të dokumentit me palët e interesuara, AKEP vijon me vendimmarrjen për miratimin e dokumentit përfundimtar, si edhe miratimin e vendimeve individuale për sipërmarrësit e përcaktuar me fuqi të ndjeshme dhe vendosjen e masave rregullatore në tregjet e shumicës të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë fikse.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të pikave 1 të nenit 14 dhe 15 të neneve 44 dhe 45 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë nxjerrjen për Këshillim Publik të dokumentit “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse*”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Procedura e Këshillimit Publik të kryhet për një periudhë 45 ditore nga data e publikimit të dokumentit në faqen e internetit të AKEP.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti për Këshillim Publik “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse*”, të publikohen në faqen e internetit të AKEP : www.akep.al.
4. Ngarkohet Drejtoria Rregullatore dhe Mbikëqyrjes së Tregut për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Gentian Sala

Edlira Dvorani

Lorenc Bako

Bleron Dokle

Armer Juka